



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:050814

Datë: 29.04.2024

Numri i dokumentit: 05633118

KPPP.nr.1776/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit “CDC” SH.P.K., me NRB:70720167, me seli në Gjilan, rruga “Bulevardi i Pavarësisë” Hy.2.2/A, kundër debitorit Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.77/21 të datës 19.02.2021, të Përmbartuesit Privat Kushtrim M. Musa, me seli në Gjilan, jashtë seancës me datë 29.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, ANULOHET Urdhri Përmbartimor P.nr.77/21 i datës 19.02.2021, i Përmbartuesit Privat Kushtrim M. Musa, dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “CDC” SH.P.K., ka caktuar urdhrin përmbartimor P.nr.77/21 të datës 19.02.2021, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr.11.2020 të datës 11.11.2020, dhe Faturës Nr.10.2020 të datës 11.11.2020, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij urdhri t’ia paguaj kreditorit borxhin në shumën prej 12,394.85 €, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e lejimit të këtij urdhri e deri në pagesën definitive dhe shpenzimet e përmbartimit nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm, në të kundërtën përmbartimi të ekzekutohet me bllokimin e llogarive të debitorit në të gjitha Bankat Komerciale në Kosovë dhe me bartjen e mjeteve në llogarinë e kreditorit, regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të pasurisë së debitorit deri në pagimin e borxhit të tij.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit brenda afatit ligjor, debitori ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor, duke theksuar se kërkesat e debitorit sipas faturave të cilat janë objekt i kësaj procedure përmbarimore, nuk janë të pranuar nga ndonjë komision pranimi të punëve, e as nga menaxheri i projektit. Tutje ka shtuar se kreditori punimet të cilat i ka kryer në spitalin e përgjithshëm në Gjilan, punimet e realizuara kanë qenë në përputhje me kontratën “Renovim i Ambulancave në Gjilan” si dhe të gjitha obligimet janë kryer nga autoriteti kontraktues sipas faturave të cilat i janë bashkangjitur raportit nga ana e menaxherit të kontratës, në të cilat është bërë e qartë se cilat punë janë kryer në bazë të situacioneve të cilat i janë bashkangjitur lëndës. Po ashtu ka theksuar se faturat të cilat janë objekt i kësaj procedure përmbarimore nuk janë të qarta, nuk dihet se për çfarë bëhet fjalë për cilat punë të kryera nuk është përmbushur obligimi, të njëjtat nuk janë pranuar nga debitori, si dhe janë tërhequr nga libri i protokollit të debitorit me nënshkrim nga kreditori, andaj të njëjtat nuk kanë vullë pranimi nga ana e debitorit si dhe nuk janë të specifikuara se për cilat pozicione bëhet fjalë. Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet prapësimi i debitorit, si dhe të detyrohet kreditori që t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësimin e debitorit, me të cilin ka kundërshtuar pretendimet e debitorit, duke theksuar se në prapësim debitori është ndërlidhur me fatura, shkresa dhe raporte të pagesave të mëhershme të cilat nuk janë pjesë kontestuese si dhe nuk ndërlidhen me faturat të cilat janë objekt i kësaj procedure përmbarimore. Tutje ka shtuar se nuk qëndron pretendimi i debitorit se faturat nuk janë pranuar nga debitori, pasi që të njëjtat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt të protokolluara me numër protokolli si dhe me datën e pranimi, andaj të njëjtat i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë objekt i procedurës përmbarimore. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit si dhe të obligohet debitori që t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës.

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin PPP.nr.413/21, të datës 30.07.2021, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër urdhrin përmbarimor P.nr.77/21 të datës 19.02.2021, të lëshuar nga Përmbaruesi Privat Kushtrim M. Musa.

Debitori me datë 18.08.2021, ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës përmbarimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar Gjykatës së Apelit, që të aprovet ankesa, ndërsa aktvendimi i shkallës së parë të ndryshohet.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, me Aktvendimin K.DH.SH.II.nr.251/23 të datës 05.09.2023, ka aprovuar si të themeltë ankesën e debitorit, ka anuluar aktvendimin e atakuar dhe çështja i është kthyer Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërejtjeve sipas aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet dhe procedura përmbarimore të përfundohej në tërësi për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbarim, nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa në par.1 nën par. 1.3 të po këtij neni, si dokument i besueshëm sipas ligjit konsiderohen: *“faturat”*, ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se Fatura Nr.11.2020 e datës 11.11.2020, dhe Fatura Nr.10.2020 e datës 11.11.2020, në bazë të së cilave është lejuar propozimi për përmbarim, nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara ligjore për të qenë dokumente të besueshme dhe nuk janë të përshtatshme për përmbarim, meqenëse në këto dokumente nuk është përcaktuar saktë objekti i detyrimit, përkatësisht nuk janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt

i faturës dhe nuk mund të konstatohet se për çfarë lloj pune/shërbimi është kërkuar përmbushja e detyrimit nga debitori.

Gjykata deri te ky vlerësim erdhi pasi që me propozimin për përmbarim kreditori ka kërkuar përmbushjen e borxhit në shumën prej 12,394.85 €, përkatësisht sipas Faturës Nr.11.2020 të datës 11.11.2020, është kërkuar përmbushja e borxhit në shumë prej 4,175.00 €, mirëpo tek përshkrimi figuron vetëm “Pagesa e situatës sipas kontratës me numër prokurimi 220-19-1288-521 të datës 16.05.2019 dhe titull Renovim i Emergjencës në Gjilan”, ndërsa nuk është përshkruar se për cilat punë ose shërbime është lëshuar, ndërsa sipas Faturës Nr.10.2020 të datës 11.11.2020, është kërkuar përmbushja e borxhit në shumën prej 8,219.85 €, mirëpo tek përshkrimi figuron vetëm “Pagesa e situatës sipas kontratës me numër prokurimi 220 19 017 521 të datës 05.07.2019 me titull Renovim i ambulanteve në Gjilan”, ndërsa nuk është përshkruar se për cilat punë ose shërbime është lëshuar e njëjta dhe si rrjedhojë këto dokumente nuk pasqyrojnë qartë detyrimin që rrjedh nga të njëjtat dhe nuk përmbajnë atributet e një dokumenti të besueshëm.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumentet e besueshme mbi të cilat mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilave Përmbaruesi Privat ka lejuar përmbarimin nuk kanë tipare të përmbarueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat duhet të anulohet.

Gjykata në kuptim të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1776/23, datë 29.04.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.